



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VORË  
KRYETARI

Nr. 2071 prot.

Vorë, më 12.04.2023

**VENDIM**

Nr. 51, datë 12/04 /2023

**PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE DHE EDUKATIVE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET VENDORE TË DATËS 14.05.2023.**

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8 pika 2, ligjit 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 79, Udhezimit Nr.06, date.23.03.2021 'Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore';

**VENDOS:**

1. Caktimin e qytetit Vorë, Prezë qendër, Kala dhe Bërxullë qendër për afishimin i materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet vendore të datës 14.05.2023. Me mbarimin e fushatës zgjedhore, subjektet zgjedhore marrin masat për heqjen e të gjithë materialeve propagandistike.
2. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit apo shtyllat e ndriçimit dhe në mjetet e transportit publik.
3. Afishimi i materialeve edukuese zgjedhore, në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së) ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar, bëhet në të njëjtat vende si me lart dhe pranë qendrave të votimit.
4. Policia Bashkiake të monitorojnë procesin e afishimit si dhe të marrë masa për heqjen e tyre në rast të vendosjes së tyre në kundërshtim me rregullat, sipas funksioneve të caktuara në legjislacionin përkatës.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**BLERIM SHERA**

